

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dita e 118-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: J u erdhi fundi!
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/dita-e-118-te-e-protestes-qytetaret-zbresin-serish-ne-shesh-kerkohe-i516036
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 17:00:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 16:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1f0dca5373349a0e2ea11756494c1681e0c5b220db8d2ee4d04ac880c2bb72aa
TEKSTI	82f343b46851682c1b38f24adc867e2cbeb981824336b6cc50aa2d4371fe7295
PAMJA	75774178416f1133a8ce9f815e690da72a1f5175f3932ec77c90b3507af0056b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	eeeccd630f12d17c3f9df45372b16ba1ce1abbaede879c88f8b82098252f729f
E MËPARSHMJA	6da64796e275a692b061e3e66753cef5493f08a74a41b2fa7335097dd1e83b53
RRËNJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/eeeccd630f12d17c3f9df45372b16ba1ce1abbaede879c88f8b82098252f729f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

49 MINUTA ME PARE

"Shqipëria po përjeton të ardhmen që të tjerët ende po e diskutojnë"/ Rama nga OKB: Algoritmi aktivizoi urrejtjen, qytetarët protestuan kundër një armiku fantazmë

2 ORE ME PARE

Dita e 118-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

4 ORE ME PARE

"Shqipëria e shqiptarëve është slogan i neveritshëm dhe i turpshëm"/ Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës

6 ORE ME PARE

Konflikt në Durrës/ Shefi i Policisë së Krujës përplaslet fizikisht me pronarin e ish-hotelit "Mira Mare": Nuk e kam kërcënuar, më shau, e shava

LIVE UPDATES

Dita e 118-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

• Qytetarët u mbledhën sot në ditën e 118-të të revoltës së tyre. • Ata u organizuan fillimisht në sheshin "Skënderbej" dhe më pas vijuan marshimin drejt Kryeministrisë, ku dhe zhvilluan fjalimet e tyre. • Të shumtë ishin qytetarët të cilët folën në podiumin e vendosur para Kryeministrisë, ku artikulluan kërkesat e tyre dhe bënë thirrje për ndryshim. • Aktivisti Edison Lika ishte një nga folësit në protestën e ditës së sotme. • Gjatë fjalës së tij në podiumin e vendosur para Kryeministrisë, ai u shpreh se kryeministri Rama do ta mbyllë karrierën e tij politike me pranga. • Lika deklaroi se faza e kërkesës për dorëheqjen e kryeministrit ka përfunduar dhe se protestat do të vijojnë me një tjetër thirrje. • Aktivisti tha se kjo rezistencë ka bërë që çdo qytetar mund të shohë më afër se kurrë rrëzimin e këtij regjimi. • Aktivisti Arben Kola falenderoi shqiptarët në SHBA, të cilët pritën me vezë kryeministrin Edi Rama. • Duke folur para qytetarëve, Kola tha se kryeministri qëndron në dhomë 15 mijë dollarë nata, ndërsa spitalet janë pa ilaçe. • Ai tha se protestuesit kërkojnë dorëheqjen e kryeministrit dhe qeverisë, krijimin e një qeverie teknike tranzitore dhe ndryshime kushtetuese. • Aktivisti Erald Ndoj iu drejtua publikisht ambasadorit të ri të Amerikës, Eric ëndt, duke kërkuar mbështetje dhe ndihmë për situatën politike në Shqipëri. • Gjatë fjalës së tij në podiumin e vendosur para Kryeministrisë ai e përshkroi situatën në vend si një prej periudhave më të vështira, ndërsa theksoi lidhjet e forta të shqiptarëve me Shtetet e Bashkuara. • Protesta e cila nisi si një reagim i drejtpërdrejtë ndaj situatës së ndodhur në Zvërnec, përfundoi në kërkesën për dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama. • Me pankarta në duar dhe flamuj kugezi, protestuesit kanë bërë thirrje për ndryshim. • Protesta ka bërë bashkë fëmijë, të moshuar, studentë, profesionistë, aktivistë dhe turistë. • Qytetarët kanë kërkuar plotësimin e pesë kërkesave të cilat përfshijnë dorëheqjen e panegociushme të kryeministrit Rama, krijimin e një qeverie teknike dhe ndryshime kushtetuese. • Tubimet janë shoqëruar me marshime nëpër rrugët kryesore të Tiranës, ndërsa qytetarët kanë ndaluar edhe pranë institucioneve të tjera, përfshirë Parlamentin, ku kanë përcjellë mesazhe ndaj deputetëve. • "Edi Rama, o tradhtar, me Shqipërinë mos bëj Pazar", "Rama, jep dorëheqjen", "Pa rini nuk ka Shqipëri", "Poshtë patronazhistët", "Shqipëria e shqiptarëve, vdekje tradhtarëve", "Shqipëria kërkon revolucion", "O Erion, o legen, prite Ramën se po vjen" dhe "Ju erdhi fundi", këto ishin disa nga thirrjet e tyre.

7 artikuj për këtë temë.

23 MINUTA ME PARE

Protestuesit nuk i ndal as shiu/ Vijon marshimi në Tiranë: Pa rini nuk ka Shqipëri



editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje



Pamje

TIRANA- Protestuesit kanë mbyllur fjalimet e tyre para Kryeministrit dhe kanë nisur marshimin në rrugët e kryeqytetit, ndërsa i kanë qëndruar bindshëm revoltës së tyre pavarësisht kushteve atmosferike. “Ju erdhi fundi!”, “Pa rini nuk ka Shqipëri!” dhe “Anuloni ligjet!”, këto janë ndër thirrjet e dëgjura gjatë marshimit.

Ata kanë bërë thirrje për dorëheqjen e kryeministrit Rama, ndërsa kanë kërkuar edhe krijimin e një qeverie tranzitore. Me pankarta në duar dhe flamuj kuqez, ata kanë bërë thirrje për ndryshim./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Mbyllen fjalimet te Kryeministria, nis marshimi në rrugët e Tiranës



Pamje

TIRANA- Protestuesit kanë mbyllur fjalimet para Kryeministrit për shkak të kushteve të vështira atmosferike dhe kanë nisur marshimin në rrugët e Tiranës. Të shumtë ishin qytetarët të cilët folën në podiumin e vendosur para Kryeministrit ku bënë thirrje për ndryshim dhe kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama. “Edi Rama, jep dorëheqjen”, “Ju erdhi fundi”, “Rama në burg, Berisha në burg” dhe “Ndryshim sistemi” ishin disa prej sloganeve të përsëritura gjatë protestës.

Edhe sot, protesta ka spikatur duke bërë bashkë shtresa të ndryshme të shoqërisë, nga fëmijë e të moshuar, te studentë, profesionistë, aktivistë të cilët i janë bashkuar qëndresës qytetare. Tubimi shënon ditën e 118-të të protestave, ndërsa qytetarët vijojnë të shprehin kundërshtimin e tyre ndaj qeverisë përmes pankartave, sloganeve dhe marshimit në kryeqytet./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Aktivisti thirrje ambasadorit të ri të SHBA-vë: Na jepni një dorë, duam të krijojmë një qeveri të fortë!



INSIGHTS 25 SHTATOR 2026, 20:57

Kur të bie Diella në kokë

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 12:08

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)

POLITIKE 25 SHTATOR 2026, 10:13

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit

më të klikuarat

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

VIDEO/ Pamje të rënda nga atentati në Sarandë! Artan Myrtaj vrapon për t'u shpëtuar plumbave, autorët e ndjekin dhe qëllojnë në mes të rrugës

"Europa nuk ka arritur ta zbatojë"/ Rama nga SHBA: Paqja kusht politik që zhvillimi ekonomik e bën të mundur

insights

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim na ndëstebat në



Aktivisti

TIRANA- Aktivisti Erald Ndoj iu drejtua publikisht ambasadorit të ri të Amerikës, Eric Wendt, duke kërkuar mbështetje dhe ndihmë për situatën politike në Shqipëri. Gjatë fjalës së tij në podiumin e vendosur para Kryeministritë ai e përshkroi situatën në vend si një prej periudhave më të vështira. Kjo ndërsa theksoi lidhjet e forta të shqiptarëve me Shtetet e Bashkuara.

“Sot Zoti Eric Wendt Shqipëria sot është në ditët më të vështira. Shqipëria është kombi më amerikandashës. Sot Shqipëria ka nevojë për më shumë se ju. Kemi nevojë sepse po na cënohet sovraniteti, e drejta themelore. Ju bëj një lutje na jepni një dorë sepse ju garantojmë se nuk do lejojmë që të vijmë kurrë këto ditë të zeza. Na ndihmoni të krijojmë një qeveri të fortë”, tha nder te tjera aktivisti./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Protesta e 118-të/ Arben Kola: Kryeministri qëndron në dhomë 15 mijë dollarë nata, ndërsa spitalet janë pa ilaçe



Aktivisti Arben Kola

TIRANA- Aktivisti Arben Kola falenderoi shqiptarët në SHBA, të cilët priten me vezë kryeministrin Edi Rama. Duke folur para qytetarëve, Kola tha se kryeministri qëndron në dhomë 15 mijë dollarë nata, ndërsa spitalet janë pa ilaçe.

Aktivisti tha se protestuesit do të vijojnë aksionin dhe përsëriti kërkesat e tyre. Ai tha se protestuesit kërkojnë dorëheqjen e kryeministrit dhe qeverisë, krijimin e një qeverie teknike tranzitore dhe ndryshime kushtetuese.

po kështu edhe
pallat

Auron Janku


Kur PARTITË
harrojnë pse
ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1
euroshit ku Rama
zgjedh kush bëhet
biznesmen

Moti

Powered by  tomorrow



Aktivisti Arben Kola: Dua të nis me një falënderim për shqiptarët e Amerikës dhe një prej koordinatorëve që qëllloi në shenjë. Një patriot nga Dibra që është pjesë e protestës që ditën e parë. Dua ta falënderoj nga zemra dhe duhet të vazhdojmë betejën, se nesër do të jetë sërish në Asamblenë e OKB-së Ramoviçi, bashkë me Tao Taon dhe servilat e tjera, të cilët po e shoqërojnë në Amerikë.

Ndërkohë që pensionistët vuajnë, spitalet pa ilaçe, ai fle në hotele me 15 mijë dollarë nata, Ramovicci. Ndërsa Tao në dhoma me 10 mijë dollarë nata. Imagjinoni çfarë talljeje bëhet me shqiptarët. Dua t'ju kujtoj se kërkesat tona nuk kanë ndryshuar. Një, dorëheqja e panegociueshme e kryeministrit dhe qeverisë. Krijimin e një qeverie teknike tranzitore, ndryshime kushtetuese dhe miratimin e tyre me referendum, ku përfshihet ndryshimi i Kodit Zgjedhor. Ndryshimin e ligjit për financimin e partive politike. Kufizimin e ushtrimit të detyrës së kryeministrit në jo më shumë se dy mandate. Për çdo kryeministër që do të vijë në të ardhmen, jo më shumë se dy mandate. E para është dorëheqje, dorëheqje, dorëheqje./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Protesta kundër qeverisë/ Aktivisti Edison Lika: Rama do ta mbyllë karrierën e tij politike me pranga



Edison Lika

TIRANA- Aktivisti Edison Lika ishte një nga folësit në protestën e ditës së sotme. Gjatë fjalës së tij në podiumin e vendosur para Kryeministrit, ai u shpreh se kryeministri Rama do ta mbyllë karrierën e tij politike me pranga.

Lika deklaroi se faza e kërkesës për dorëheqjen e kryeministrit ka përfunduar dhe se protestat do të vijojnë me një tjetër thirrje. Aktivisti tha se kjo rezistencë ka bërë që çdo qytetar mund të shohë më afër se kurrë rrëzimin e këtij regjimi.

“Nga sot u themi kryeministrit se koha për dorëheqje ka mbaruar, nga sot do thërrasim arrestoni Ramën. Rama nuk do jetë aq me fat sa të mbyllë karrierën politike me dorëheqje, ai do ta mbyllë karrierën politike në pranga”, tha Lika./Dosja.al

2 ORE ME PARE

118 ditë protestë/ Nis grumbullimi i qytetarëve në sheshin Skënderbej

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.